



Prishtinë: 13.06.2017

Kodi i ZRRE-së: V_992_2018

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1785_03_18**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **30.04.2018**.

në seancën e mbajtur më datë 13.06.2018, nxori këtë:

V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e KESCO-së ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin S. Z., nga Lipjani me shifër të konsumatorit: DFE - 46793 si e pa bazuar.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_1785_03_18 i datës 21.03.2018.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 30.04.2018 ka pranuar ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkalës së parë për këto shkaqe: Përfaqësuesi i KESCO-së, në ankesë ka theksuar se rezultati i shqyrtimit të njehsorit elektrik nr.38952945 kanë theksuar se njehsori elektrik është brenda kufijve të lejuar të matjes dhe se si pasojë e këtij rezultati është bërë faturimi i muajit 12/2015 pa bërë ndonjë korigjim të mundshëm. Në ankesën e KESCO gjithashtu është theksuar se DMK në ZRRE vendimin e tij e nuk e bazon në raportin e kalibrimit por vetëm nga rrjedha e energjisë elektrike për muajin e njëjtë të vitit paraparakë, pra në shpenzimin e energjisë elektrike para dhe pas periudhës kontestuese. KESCO në ankesën e tyre kanë theksuar se kërkojnë nga Bordi i ZRRE-së që pezullojnë vendimin e DMK-së nr. ZRRE/DMK_V_1785_03_18 i datë 21.03.2018 për konsumatorin S. Z. me shifër DFE - 46793.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 09.02.2017 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejt dhe i bazuar në prova konkrete.

Bordi i ZRRE-së gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës ka vlerësuar si të bazuara konstatimet e bëra nga shkalla e parë në të cilat theksohet se pas dyshimit të konsumatorit në matjen e energjisë elektrike, punëtorët e autorizuar të KEDS-it për ndërrim njehsori me datë 19.01.2016 kanë inspektuar



pikën matëse të konsumatorit, ku kanë larguar nga matja njehsorin elektrik nr.38952945 me gjendje TL=20329 kWh dhe TU=9059 kWh, si dhe i është vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 30516191 me gjendje të shpenzimeve TL=000000 kWh dhe TU= 000000 kWh, dhe kanë theksuar se njehsori elektrik duhet të dërgohet në qendrën e kalibrimit pasi që njehsori i vjetër shpenzon shumë.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar edhe protokollin e shqyrtimit të njehsorit elektrik nr.org. 02 nr. 5441 i datës 12.04.2016, në të cilën është konstatuar se *“Njehsori elektrik është në rregull, njehsori elektrik ka bllokat shtetërore, nga ana e jashtme njehsori dëmtime nuk ka si dhe kanë konstatuar se gabimi në matje është +0.77%”*. Pra, Bordi i ZRRE-së thekson se bazuar në të gjeturat përkatësisht shqyrtimin e saktësisë së matjes nga qendra e kalibrimit për njehsorin elektrik nr.38952945, konstatohet se gabimi në matje është brenda kufijve të lejuar matës, mirëpo duhet pasur parasysh se punëtorët e autorizuar të vet KEDS-it gjatë ndërrimit të njehsorit elektrik kanë theksuar se njehsori i vjetër është duke shpenzuar shumë, pra kemi dy procesverbale të vet KEDS-i që janë në kundërtënie në mes veti.

Sa i përket pikës së kundërshtimit se nuk duhet të merret parasysh krahasimi i shpenzimit të energjisë elektrike kjo nuk qëndron sepse shpenzimi i energjisë elektrike është indikacion mjaft i rëndësishëm në shqyrtimin e lëndëve të konsumatorit. Bordi i ZRRE-së ka analizuar me kujdes shpenzimin e energjisë elektrike dhe konstaton se konsumatori ka lexim dhe faturim të rregullt të shpenzimeve të energjisë elektrike. Lidhur me këtë Bordi i ZRRE-së ka bërë krahasimin e shpenzimeve për periudhën kontestuese me periudhat e njëjta të më mëvonshme me njehsorin e ri elektrik nr. 30516191 dhe vërteton se konsumatori ka ndryshim në shpenzimin e energjisë elektrike. Sipas rrjedhës se energjisë elektrike shpenzimi i konsumatorit për periudhat e mëhershme me njehsorin kontestues nr.38952945: periudha 12/2014 është **672 kWh**, periudha 12/2013 është **878 kWh**, kurse për periudha të mëvonshme me njehsorin e ri elektrik nr.30516191: periudha 12/2016 është **407 kWh**, si dhe periudhën 12/2017 është **430 kWh**. Bordi i ZRRE-së bazuar në analizat e bëra konstaton se konsumatori në periudhën kontestuese 12/2015 nuk është faturuar me shpenzimet reale për shkak se shpenzimet e mëhershme, si dhe të mëvonshme të konsumatorit me njehsorët elektrik nr.38952945 dhe nr.30516191 janë shumë më të ulëta në krahasim me shpenzimet e faturës së muajit të kontestuar 12/2015. Pra shpenzimet e energjisë elektrike të njehsorëve elektrik nr.38952945 dhe nr.30516191 nuk përputhen me shpenzimet e faturuara për periudhën 12/2015. Gjatë analizës se rrjedhës se energjisë elektrike po ashtu konstatohet se gjendja e fundit e shpenzimeve të evidentuara në procesverbalin mbi ndërrimin e njehsorit elektrik nr.0629582 të datës 19.01.2016 nuk përputhet me gjendjen e evidentuar në CCP pasi që ekziston një dallim i madh në mes leximit të fundit të datës 24.12.2015 dhe kohës se ndërrimit të njehsorit 19.01.2016. Ky dallim i kWh është TL=3805 kWh dhe TU=1622 kWh dhe se po ashtu vërtetohet se konsumatorit nuk i është bërë kjo prerje edhe në CCP pra nuk figuron gjendja e fundit e shpenzimeve pas ndërrimit të njehsorit elektrik nr.38952945.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejt dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 09.02.2017 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- KESCO-së, dhe
- Konsumatorit S. Z., dhe
- Arkivit të ZRRE-së.